



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 2538/Prot.

Tiranë, më 16.3.2018

**Lënda:** Kërkesë për bashkëpunim për procesin e rivlerësimit

**ShTZ. Edi RAMA**  
**Kryeministër**

**Z.Helidon Bendo**  
**Zëvendës drejtor i Shërbimit Informativ Shtetëror**

Tiranë

*I nderuar zoti Kryeministër!*

*I nderuar zoti Zëvendës drejtor!*

Procesi i rivlerësimit kalimtarë të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë është edhe fillimi i procesit të reformës në drejtësi i iniciuar nga shteti shqiptar. Në përmbushje të misionit kushtetues të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar procesin e rivlerësimit të subjekteve. Gjatë procesit të rivlerësimit Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, heton dhe vlerëson të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

Referuar shkronjës “DH” të Aneksit Kushtetues, subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet kontrollit të figurës, me qëllim identifikimin, nëse kanë ose jo, kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të *provojë të kundërtën*.

Meqënëse Kushtetuta shprehet për kalimin e barrës së provës tek subjekti i rivlerësimit, është e domosdoshme që Komisioni të disponojë/administrojë dokumentet që provojnë apo bindin atë për lidhje të mundshme të subjektit të rivlerësimit me kontakte të papërshtatshme. Po ashtu, në zbatim të ligjit nr.84/2016, Komisioni duhet të krijojë bindjen e brendshme nëse është apo jo, subjekti i rivlerësimit, i përfshirë në veprime korruptive apo ka lidhje dhe kontakte të papërshtatshme. Më tej është Komisioni ai që duhet të vlerësojë nëse informacioni që ai disponon si provë mund të përdoret publikisht



në një proces administrativ publik apo ai përmban sekret shtetëror dhe duhet kufizuar. Në këtë rast Komisioni mund të përdorë si argument (bazë ligjore) vendimin e gjykatës së Strasburgut “*Case of Regner v. The Czech Republic*”. Duke studiuar këtë vendim, duket qartë se fokusi në një proces të rregullt ligjor është *barazia e armëve*. Edhe Kushtetuta jonë shprehet qartë, duke i kaluar subjektit barrën e proves, në çdo rast konstatimi të një informacioni apo dyshimi mbi figurën e subjektit të rivlerësimit. Vetë *rasti Regner* ka patur debat dhe diskutime, por në fund gjykata ka vlerësuar se kufizimi për njohjen me dokumente sekrete që përbëjnë “sekret shtetëror”, është e drejtë legjitime, por në çdo rast të gjitha gjykatat janë njohur me këtë informacion, i cili i ka ndihmuar atao për të krijuar bindjen e brendshme, ashtu sikurse edhe ligji ynë e kërkon.

A mjafton raporti i përgatitur nga DSIK, për të vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në rastet kur ai del me konkluzionin “*I papërshtatshëm*”? Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.2/2017, KPK, duhet të kryejë një hetim të thelluar, më konkretisht ajo shprehet se: “41. *Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”*

Komisioni duhet të bazojë vendimin vetëm në dokumente nga burime të njohura e në prova të besueshme. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo informacion lidhur me çështjen.

Në vijim të sa thamë më sipër, nëse u referohemi tre rasteve të ndryshme, çështja Selimi, Toska dhe Broci, raportet nga DSIK kanë ardhur të ndryshme, bindja e komisionit është disi e ndryshme nga konkluzionet e nxjerra nga raportet. A mundet Komisioni të veprojë në padijeni totale të informacionit, që ka shërbyer për përgatitjen e këtij raporti? A mundet komisioni t’i kalojë barrën e provës subjektit të rivlerësimit për një konkluzion, të cilin as ai vetë nuk ka mundur ta vlerësojë dhe të krijojë bindjen e brendshme mbi këtë çështje? Një vendim i tillë do të ishte lehtësisht i kontestuar nga çdo gjykatë më e lartë dhe do të binte ndesh me parimin e një procesi të rregullt ligjor.

I nderuar zoti Kryeministër,  
I nderuar zoti zëvendësdirjtor i Shërbimit Informativ Shqiptar,

Procesi i Vettingut pritet të kthejë besimin tek drejtësia. Ne jemi duke punuar pa reshtur për të kryer një proces të rregullt e të drejtë, por është themelore që ky proces të jetë i drejtë për të gjitha palët, që vendimet tona të mos jenë të njëanshme, që Kushtetuta dhe ligjet e vendit të respektohen.

Lutemi të merrni në konsideratë kërkesën tonë të vazhduar që shërbimet inteligjente të mundësojnë dhënien e informacioneve sekretë që ata disponojnë, me garancinë e plotë të ruajtjes së sekretit nga ana jonë. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mendon se suksesi i këtij procesi duhet të jetë i lidhur me bashkëpunimin nga të gjitha oraganet shtetërore, të cilat duhet të na vënë në dispozicion informacionet që ato disponojnë, pa dyzime apo kufizime.

Duhet të mbajmë në vëmendje edhe kohën në të cilët organet shtetërore duhet të veprojnë. Vetë ligji nr.84/2016 ka parashikuar se organet shtetërore duhet të veprojnë shpejt, brenda një afati 15 ditor, duke e konsideruar këtë afat si shumë të rëndësishëm dhe duke e konsideruar si mungesë bashkëpunimi në dhënien e informacioneve, vonesat në afate.

Duke e mirëkuptuar rëndësinë e punës suaj fisnike Ju kërkojmë të keni besim në institucionin tonë dhe të bashkëpunoni me ne pa rezerva dhe vetëm atëherë mund të kemi një proces të plotë të drejtë dhe vendimarrje të pakontestueshme.

Lutemi të mbani në konsideratë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.2/2017 si dhe Vendimin e Gjykatës së Strasburgut "*Case of Regner v. the Czech Republic*".

Me besimin se, SHISH-i në veprimtarinë e tij i shërben zbatimit të Kushtetutës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në Republikës së Shqipërisë dhe përmbushjes së misionit të vet për sigurinë e interesave kombëtare të vendit, ruajtjen e integritetit, të pavarësisë dhe të rendit kushtetues, lutemi të merrni masa për çbllokimin e kësaj situate të krijuar artificialisht, me qëndrimet skeptike, që kufizojnë informacionin duke mos na konsideruar si organi i duhur për administrimin e tij.

Duke e konsideruar bashkëpunimin mes institucioneve si burimi i suksesit të kësaj reforme, *Ju lutemi*, me gjithë përkushtimin dhe gatishmërinë tonë për ta çuar këtë proces deri në fund, të jeni të hapur dhe bashkëpunues me Komisionin.

Falënderit për mirëkuptimin,



